

ANA LALAJ

SHQIPËRIA: NGA PAKTI I VARSHAVËS NË NATO

Traktati i Varshavës u nënshkrua më 14 maj 1955, nga qeveritë e tetë vendeve komuniste të Evropës Lindore e Qendrore, midis të cilave edhe Shqipëria¹. Ai hyri me emërtimin standard: “Traktati i Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndhmës Reciproke”, por në fakt ishte një pakt i mirëfilltë politiko-ushtarak, që siç u deklarua në atë kohë, u krijua si kundërpeshë ndaj NATO-s dhe përfshirjes brenda saj të Gjermanisë Perëndimore², për të cilën shprehej frika e rimilitarizimit të saj.

Aleanca të këtij lloji, kur është fjala për qëllime mbrojtëse, tradicionalisht janë krijuar në kohë tensionesh dhe rreziqesh të identifikuar. Në kohën kur u krijua NATO, më 1949, Stalini i kishte vënë në kontroll të rreptë vendet e Lindjes. Edhe qëndrimet përjashtuese që Perëndimi kishte mbajtur me Moskën (për shembull, Plani Marshall, më 1947), e kishin nxitur më tej revanshin sovjetik. Me këtë rast, Stalini kishte shpërndarë qeveritë e koalicioneve, duke i shndërruar ato në tërësisht komuniste. Në Pragë kishte ndërhyrë brutalisht, ndërsa Berlinit Perëndimor i ndaloi furnizimet me mallra dhe ushqime që vinin nga Gjermania Perëndimore. Në këtë mënyrë, BS u shfaq si një rrezik i ri në Evropën e pasluftës. Si reagim, u krijua NATO, një aleancë politike - ushtarake e Perëndimit dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si pjesë e saj.

Gjashtë vjet më pas, më 1955, kur u krijua Pakti i Varshavës, midis Lindjes dhe Perëndimit kishte filluar “shkrirja e akujve” ose, siç është quajtur ndryshe “Detanta e parë”. Në politikën e jashtme, N. Hrushovi kishte dalë në publik me idenë e tij të njohur të bashkekzistencës paqësore me Perëndimin, e cila gjeti mbështetje. “Ka vetëm dy rrugë,

¹ Anëtarët themelues të Paktit të Varshavës ishin: BRSS, RP e Bullgarisë, RP e Çekosllovakisë, RP e Hungarisë, RP e Polonisë, RP e Rumanisë, RD Gjermane dhe RP e Shqipërisë.

² Gjermania Perëndimore u pranua në NATO më 9 maj 1955, 10 vjet pas nënshkrimit të aktit të kapitullimit të saj me shtetet e koalicionit antifashist.

shprehej ai, ose bashkekzistencë paqësore, ose lufta më shkatërrimtare në histori”³. Në Hemisferën tjetër, Presidenti Ajzenhauer jepte siguri se “populli amerikan dëshironte të ishte miqësor me popullin e BS”⁴. Në reformat e brendshme, dy vjet pas vdekjes së Stalinit, N. Hrushovi kishte avancuar mjaft në kursin ambicioz të destalinizimit si brenda BS, ashtu edhe në vendet e tjera të “kampit”. U mbyllën gulakët dhe u rehabilituan shumë nga të burgosurit politikë. U shpërnda Kominformi dhe u hoq gjendja e luftës me Gjermaninë. Në forcat ushtarake u bënë shkurtime dhe fondet për armatime u pakësuan. Në Shtetet e Bashkuara, antikomunizmi fanatik i Jozef McCarthy-t kishte marrë përgjigje ndëshkuese. Operacionet “Rollback” në disa vende të Lindjes, përfshirë dhe Shqipërinë, u ndërprejnë. Po kështu, luftërat në Kore dhe Indonezi morën fund. E të tjera.

Atëherë, përse u krijua Pakti i Varshavës?

Arsyeja ishte strategjike. Pas vijës ndarëse me Lindjen, Perëndimi ishte kompaktësuar mjaft. Hrushovi ndjehej i shqetësuar, se pikërisht kjo i mungonte Lindjes. Ai e kishte kuptuar dhe besonte se Aleanca Atlantike nuk përbënte ndonjë kërcënim ushtarak për vendin e tij dhe bllokun në tërësi. Por, nëse në pikëpamje ushtarake NATO ishte në pozicione mbrojtëse, në pikëpamje politike ajo ishte “agresive”. Kjo buronte nga vetë misioni i NATO-s, nga kredoja morale e përhapjes së shembullit, e modelit të sistemit, e garancive të lirisë etj. Prandaj më shumë se luftës, Hrushovi i trembej shturjes së “kampit”. Dhe për të mbajtur në kohezion e kontroll “familjen komuniste”, gjeti një mekanizëm të ri politiko-ushtarak, “vëllazërimin nën armë”. Kjo mendoj se është, në mos kryesorja, së paku një arsye më shumë pse u krijua Pakti i Varshavës. Ngjarjet e një viti më vonë në Poloni dhe Hungari e provojnë këtë tezë. Qeveritë e vendeve anëtare të Paktit dhanë miratimin që tanket sovjetike, të drejtuara për në Budapest, të kalonin nëpër territoret e tyre. Në këtë mënyrë, këto qeveri u bënë pjesë e një operacioni ushtarak.

³ Norman Lowe, *Modern World History*, Palgrave, Macmilan, 2005, f.132.

⁴ *Po aty.*

*Si e përdori anëtarësinë në Paktin e Varshavës
udhëheqja politike shqiptare?*

Siç ndodh zakonisht në këto raste, anëtarësimi u shoqërua me propagandën tipike të kohës se: “Shqipëria ishte pjesë e një aleance të pashembullt në histori, ku përfshiheshin 300 milion frymë, në një territor prej 23,5 milionë kilometërkatrorë”⁵. Ose deklarata si ajo e Rokosovskit, ministrit polak të mbrojtjes se: “Kush do të guxonte të prekte territorin e Shqipërisë, do t’i dërmonte nofullat grushti i fuqishëm i forcave të bashkuara të Traktatit të Varshavës”⁶, etj. Pavarësisht këtij dekori, duhet thënë megjithatë se kjo ishte organizata e parë ndërkombëtare, në të cilën merrte pjesë Shqipëria komuniste dhe udhëheqja shqiptare e shfrytëzoi këtë çast për të riformtuar autoritetin e saj. Si punë e parë, veç besnikërisë, asaj i duhej të tregonte dhe iniciativë. Në këtë plan mund të shihet edhe hapi që hodhi E. Hoxha për ta joshur Moskën, duke i propozuar ministrit sovjetik të mbrojtjes, Zhukov, gjatë një vizite në Shqipëri në tetor 1957, që në bregdetin e Vlorës të vendosej një bazë ushtarake sovjetike. Kuptohet, më parë se sovjetikëve kjo iu shtrua Byrosë Politike me arsyetimin se nëndetëset, raketat, kryqëzorët në Vlorë do t’i tregonin botës se BS do ta mbronte Shqipërinë⁷. Propozimi u pranua dhe Baza ushtarake-detare e Vlorës u bë e vetmja bazë e bllokut komunist në Mesdhe. Atje u ankoruan 12 nëndetëse, 2 baza lundruese, 12 anije të vogla mbiujëse, 24 anije ndihmëse dhe një sasi e madhe armatimesh. Sipas udhëheqjes shqiptare, Baza e Vlorës do të thoshte, ndër të tjera, që kufijtë detarë të kampit socialist të zhvendoseshin nga Deti i Zi në Gjibraltar, se do të mbahej në kontroll Flota VI amerikane në Mesdhe dhe se një sulm i forcave të NATO-s kundër RPSH do të bëhej i pamundur nga deti⁸. Në rrethanat e Luftës së Ftohtë, një logjikë e tillë ishte e kuptueshme. Por për një vend si Shqipëria, një hap si ky mbartte edhe rreziqe. Mund të thuhet kështu se ajo, me iniciativën e drejtuesve të saj politikë, u shndërrua në një “shtrat të nxehtë” të Luftës së Ftohtë.

⁵ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë (më tej: AMPJ), viti 1955, dos. 191/4, f.3.

⁶ Po aty, f.5.

⁷ Arkivi Qendror i PPSH (më tej: AQPPSH), Fondi 14, viti 1957, dos. 20.

⁸ Po aty, Fondi 14, viti 1961, dos. 1, f. 67. Traktati i Varshavës.

Sfidat e anëtarësisë së Shqipërisë në Paktin e Varshavës

Në fakt, Pakti i Varshavës ka pasur disa herë probleme të kohezionit. Ndryshe nga NATO, e cila përdorte dhe përdor konsensusin si bazë në vendimmarrje, Pakti u ngrit mbi një tjetër filozofi. Prandaj kundërshtimet kanë pasur një thelb nacionalist dhe janë drejtuar kundër diktatit të BS si në Pakt, por edhe në vetë “kampin”. Në këto kundërshtime, duke filluar nga viti 60, u përfshi edhe Shqipëria. Në formë, rasti i Shqipërisë duket i ngjashëm me atë të Hungarisë dhe të Çekosllovakisë, ku rruga nacionaliste e udhëheqësve, si Imre Nagi apo Aleksandër Dubček tentoi shkëputjen e këtyre vendeve nga Pakti i Varshavës. Por përmbajtja flet ndryshe. Nacionalizmi i udhëheqësve çekë dhe hungarezë ishte për politika kombëtare zhvillimi jo të diktuarra dhe jo të centralizuara. Ndërsa PPSH ishte e orientuar nga *nacionalizmi stalinist* i E. Hoxhës, i cili në emër të mbrojtjes së integritetit të vendit, mbylli kufijtë dhe ushqeu psikozën e rrezikut të jashtëm; në emër të identitetit kombëtar nxiti fobinë për të huajën dhe, mbi të gjitha, për të mbajtur pushtetin, nuk kurseu asnjë mjet. PPSH dhe E. Hoxha, në thelb, nuk e pranuan Kongresin e 20 dhe, ndryshe nga vendet e tjera të bllokut, ata iu shmangën reformave liberalizuese në frymën e atij kongresi.

Megjithatë deri në mbledhjen e Bukureshtit, qershor 1960, E. Hoxha, sa herë kishte shfaqur kundërshtime ndaj sovjetikëve, ai përsëri ishte tërhequr, duke kërkuar ndjesë. Por në Bukuresht, përplasjet midis udhëheqjes shqiptare dhe asaj sovjetike nuk u shmangën. Delegacioni shqiptar, që u kryesua nga Hysni Kapo, i kundërshtoi hapur sovjetikët lidhur me procedurat për trajtimin e mosmarrëveshjeve që ata kishin me Partinë Komuniste të Kinës. Tensioni i Bukureshtit, nëpërmjet komunikimeve Hoxha-Kapo, u shkarkua i tëri në Byronë Politike, duke u hedhur dyshime të forta për qëndrimet e Hrushovit dhe të drejtuesve të tjerë sovjetikë. Në dukje udhëheqja shqiptare është e pakënaqur me sovjetikët, sepse ajo, jo për herë të parë, ndjehet e mbajtur në distancë. Në rastin e fundit ajo nuk pati njoftim zyrtar nga sovjetikët se mosmarrëveshjet kino-sovjetike do të ishin temë e mbledhjes. Por më tepër se fasada parimore e procedurave, ndoshta janë për t’u vlerësuar informacionet që E. Hoxha mori nga H. Kapo për simpatitë e shprehura nga sovjetikët për Liri Belishovën, sekretare KQ të PPSH, duke e quajtur atë “heroinë” dhe “komuniste e vërtetë”, që tek Hoxha janë përkthyer si sinjale për largimin e tij nga pushteti. Ato ditë, paralel me Bukureshtin,

Belishova, gjatë një vizite në Kinë, siç ishte deri atëherë në traditë, u kishte përcjellë diplomatëve sovjetikë në Pekin të gjitha bisedat e saj zyrtare me kinezët. Gjithsesi, dokumentet sugjerojnë se më e mundshme është që tek E. Hoxha, me kohë të jetë krijuar një “ferment” anti-Hrushov, që mezi priste të shpërthente diku. Përsa i përket Liri Belishovës, si mjeshtër i këtyre situatave, E. Hoxha mbaroi punë shpejt, duke e akuzuar atë drejtpërdrejt se “donte të prishte unitetin në parti ... e t’i zinte vendin” dhe, pasi e shkarkoi nga të gjitha funksionet partiake, e internoi.

Shpërthimi ndodhi në Konferencën e 81 partive komuniste e punëtore, që u mbajt në Moskë në nëntor 1960. Në atë konferencë E. Hoxha mbajti një fjalim të gjatë dhe e akuzoi Hrushovin për veprimtari kundër PPSH, popullit shqiptar dhe deri kundër integritetit territorial të Shqipërisë, duke i kapërcyer kështu kornizat e konferencës. Ndryshimet që po ndodhnin në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ku PKK po formohej si një pol i dytë, ndikuan që E. Hoxha të mos kishte kthim prapa. Kina dhe Shqipëria u ndodhën në të njëjtën anë të barrikadës kundërhrushoviane dhe u treguan të vendosura për të ndihmuar njëra-tjetrën. PKK i siguroi Hoxhës mbështetje ekonomike dhe ushtarake, ndërsa në këmbim, Hoxha në sulmet ndaj Hrushovit mori rolin të qëndrojë disa hapa përpara kinezëve. E gjithë kjo ndikoi që mosmarrëveshjet brenda “kampit” të thelloheshin dhe për më tepër të bëheshin publike. Në fakt, udhëheqësit shqiptarë në mbledhjen e Moskës dhe më pas, morën një rol përtej kapaciteteve të tyre.

Është në natyrën e sistemeve komuniste që përplasjet ideologjike midis partive të bëhen përcaktuese në marrëdhëniet politike shtetërore midis vendeve. Kështu ndodhi dhe në raportet e Shqipërisë me BS dhe vendet e tjera, si dhe me vetë Paktin e Varshavës. Duke qenë se mosmarrëveshjet e PPSH u zhvilluan midis saj dhe kreut të kampit socialist, ishte e pritshme mënyra e rreshtimit të këtyre vendeve dhe “solidariteti” për të zbatuar ndëshkime kolektive. Mbledhja e Bukureshtit i kushtoi Shqipërisë ndërprerjen e ndihmave ushtarake nga Traktati i Varshavës, në tetor 1960. Kjo u bë e njohur si nga Hrushovi dhe, në të njëjtën linjë, edhe nga mareshali Greçko, komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Paktit të Varshavës. Ndërsa Mbledhja e Moskës, nëntor 1960, solli zhvillimet e ashpra të një viti më pas, ndërprerjen e marrëdhënieve ekonomike, shtetërore e diplomatike, deri atje sa as Stalini nuk kishte arritur me Jugosllavinë.

Viti 1961, në planin e marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet e tjera të bllokut komunist, përmban një situatë politike mjaft të përkeqësuar. Në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Paktit të Varshavës në Moskë, më 28-29 mars të atij viti, megjithëse në nivel sekretarësh të parë, Enver Hoxha nuk mori pjesë. Siç shprehet ai në ditarin e vet, këtë e bëri “për arsye sigurie”⁹. Më shumë ka të ngjarë të jetë një simulim i tij, për t’iu shmangur një mbledhjeje të “nxehtë”, pasi dihej se ai do të gjendej krejt i vetëm. Të njëjtën gjë e kishte praktikuar dhe në rastin e Bukureshtit, kur çoi atje zëvendësin e tij, H. Kapon. Në Bukuresht - për të lënë një shteg hapur, nëse do të lindte nevoja e ndonjë “retushi” të nesërm. Ndërsa në rastin e fundit kishte arsye prestigji, për t’iu shmangur një debati, ku ai ishte humbës.

Në mbledhjen e 28-29 marsit 1961, edhe pala sovjetike edhe ajo shqiptare, pohuan se gjendja në Bazën e Vlorës është e paralizuar dhe jashtë gatishmërisë luftarake. Por kur u fol për shkaqet, çdonjëra ia hodhi fajin tjetrës. Në fund, Komiteti Politik Konsultativ ishte në një zë, përjashtuar delegatin shqiptar (Beqir Balluku, ministër i Mbrojtjes), kur kërkoi që Baza e Vlorës të kompletohej vetëm me ekuipazh sovjetik. Në rast se pala shqiptare nuk pranonte, atëherë të gjitha anijet, së bashku me ushtarakët dhe specialistët sovjetikë do të largoheshin nga Shqipëria, pra Baza e Vlorës do të likuidohej”¹⁰.

Kundërshtimi i qeverisë shqiptare ishte i menjëhershëm. Më 5 prill 1961, M. Shehu, kryeministri shqiptar, bënte me dije qeveritë e shteteve anëtare të Paktit të Varshavës se Baza e Vlorës jo vetëm nuk do t’u dorëzohej ekuipazheve sovjetike, përkundrazi, ajo kërkonte që të gjitha mjetet detare dhe teknika ushtarake t’u kalonin ekuipazheve shqiptare¹¹. Sipas Shehut, ky vendim Shqipërinë e linte zbuluar përpara Flotës VI amerikane, ndërsa Paktit të Varshavës në Mesdhe i hiqej një armë e fuqishme¹². Në përgjigje të kësaj letre të qeverisë shqiptare është edhe një letër e gjatë e firmosur nga zëvendëskryeministri sovjetik A. Kosigin, më 26 prill 1961, sipas të cilës qeveria sovjetike me keqardhje njofton se

⁹ Enver Hoxha, *DITAR për çështje ndërkombëtare (1961-1963)*, Tiranë 1982, f. 53.

¹⁰ *AQPPSh*, viti 1961, dos. 1. Traktati i Varshavës.

¹¹ Në kohën e këtij letërkëmbimi, në katër nëndetëse shërbenin ekuipazhe shqiptare, ndërsa në pjesën tjetër, d.m.th. në tetë nëndetëse dhe në bazën lundruese “Kotjelnikov”, shërbimi kryhej nga ekuipazhe sovjetike.

¹² *AQPPSh*, Fondi 19, viti 1961, dos. 4.

është e detyruar të tërheqë mjetet e saj nga Vlora, si dhe i lutet qeverisë shqiptare “t’u japë udhëzime autoriteteve ushtarake që deri më 20 maj 1961 të heqin ekuipazhet shqiptare nga të gjitha anijet, nëndetëset dhe anijet ndihmuese, të cilat në kohën e vet u dërguan nga BRSS në Shqipëri për organizimin e bazës ushtarake detare në Vlorë”¹³. Kjo letër iu dorëzua kryeministrit shqiptar nga ambasadori sovjetik, më 4 maj. Qeveria shqiptare, më 8 maj, u përgjigj shkurt se në bazë të Marrëveshjeve të 12 shtatorit 1957 dhe 3 majit 1959, midis qeverive të dy vendeve, të gjitha mjetet detare që kanë ardhur në bazën e Vlorës kanë kaluar në pronësi të shtetit shqiptar dhe se për këtë midis dy palëve janë hartuar dokumentet përkatëse të rregullta¹⁴. Qeveria shqiptare shprehej, megjithatë, se “për hir të miqësisë së përhershme që lidh popullin shqiptar me popullin sovjetik”, ajo nuk do të kundërshtonte që të largoheshin mjetet detare, ku shërbimi kryhej nga ekuipazhe sovjetike. Propozohet po ashtu krijimi i një komisioni të përbashkët midis dy vendeve, i cili do të caktonte modalitetet për evakuimin e forcave ushtarake detare sovjetike nga Vlora. U kërkua që Komisioni të mbledhej në Tiranë para datës 20 maj¹⁵.

Më 18 maj mbërriti në Tiranë grupi sovjetik në këtë komision, i kryesuar nga zëvendësministri i jashtëm N. Firjubin. Puna filloi të nesërmen, por ajo u ndërpre pas një deklarate të përfaqësuesit të palës shqiptare, Halim Budo, për incidentin me ushtarakët shqiptarë të flotës luftarake detare që ndodheshin në BS¹⁶. Pasi situata u kapërcye,

¹³ *AMPJ*, viti 1961, dos. 42/5. Traktati i Varshavës, Letër e A. Kosigin drejtuar qeverisë së RPSH, më 26 prill 1961.

¹⁴ *Po aty*. Letër e qeverisë shqiptare drejtuar Këshillit të Ministrave të BRSS, më 8 maj 1961.

¹⁵ *Po aty*.

¹⁶ *Po aty*, viti 1961, dos. 42.6. Traktati i Varshavës, Diskutimet përfundimtare për Bazën e Vlorës. Në dokumentin përkatës të datës 19 maj 1961, përfshirë në këtë dosje, jepen shpjegime për çfarë ka ndodhur. Bëhet fjalë se pasi u kërkua tërheqja e forcave ushtarake detare nga Baza e Vlorës, qeveria shqiptare kërkoi të ktheheshin në Shqipëri të gjithë ushtarakët shqiptarë të flotës detare që studionin në BS. Në kohën kur Komisioni midis dy vendeve do të fillonte nga puna, ambasadori shqiptar në Moskë njofton se autoritetet sovjetike kanë penguar atashen ushtarak në Ambasadën Shqiptare në Moskë të takojë ushtarakët e marinës shqiptare dhe të organizojë nisjen e tyre për në Shqipëri. U tha gjithashtu se ushtarakët shqiptarë janë mbajtur të rrethuar në shkolla dhe nuk lejohen të kenë

Komisioni e rifilloi punën më 22 maj. Të dyja palët iu referuan shpesh Marrëveshjeve të 12 shtatorit 1957 dhe 3 majit 1959, duke e quajtur njëra-tjetrën si shkelëse të marrëveshjeve dhe shkak për situatën e krijuar në Bazën e Vlorës. Të dyja palët bënë deklaratat sidomos për pronësinë e mjeteve detare. Sipas shqiptarëve: “luftanijet dhe mjetet e tjera detare i janë dhënë falas RPSH nga ana e BS dhe janë dorëzuar me dokumente të rregullta zyrtare”. Sipas sovjetikëve: “... anijet, armatimet dhe materialet e tjera i përkasin shtetit sovjetik, ato janë pronë e shenjtë dhe e padiskutueshme e popullit sovjetik”. Më tej, përsëri sovjetikët: “Duke shkelur marrëveshjet e vitit 1957 dhe vitit 1959, pala shqiptare jo vetëm nuk mund të pretendojë për të drejtën e pronësisë mbi nëndetëset dhe anijet, por privon edhe veten nga e drejta për t’i përdorur ato”¹⁷. Meqë të dyja palët nuk lëvizën nga qëndrimet e veta, delegacioni shqiptar, më 23 maj, përsëriti ato çka përmban letra e 8 majit që qeveria shqiptare i drejtonte qeverisë sovjetike, që do të thoshte se pala shqiptare nuk do të kundërshtonte të largoheshin nga Shqipëria 8 nëndetëse dhe baza lundruese “Kotjelnikov”, bashkë me ekuipazhet sovjetike. Më 24 maj, në mëngjes, delegacioni sovjetik bëri një deklaratë ku u tha se “pala sovjetike... është e detyruar në kohën e tanishme të japë udhëzim për largimin nga Gjiri i Vlorës vetëm të një pjese të anijeve dhe të mjeteve të tjera ushtarake detare...”¹⁸. Pas kësaj, diskutimet kaluan në çështje teknike, siç është inventari i mjeteve, i pajisjeve etj., çështje me të cilat u mor një grup i veçantë me specialistë ushtarakë. Më 25 maj ishte seanca e fundit. Në këtë seancë Firjubini kërkoi të konsultohet me qeverinë e vet, sepse shqiptarët nuk pranuan që baza të mbetet e zhveshur, pa pajisje, pjesë ndërrimi, silura, detonatorë etj. Po atë seancë Firjubini njoftoi se të nesërmen, më 26 maj, në orën 8⁰⁰, në mëngjes, anijet sovjetike do të largoheshin nga Vlora. E njëjta gjë u njoftua dhe me shkrim atë pasdite¹⁹.

komunikime jashtë këtyre mjediseve. Nga autoritetet shqiptare ky u quajt veprim monstruoze i palës sovjetike.

¹⁷ *Po aty.*

¹⁸ *Po aty.*

¹⁹ *Po aty.* Letra që përmban dosja është kjo: “25 maj 1961, ora 15. Konfidenciale. Njoftim. Me këtë letër Ju njoftoj Juve, shoku zëvendësministër, se në afatin e koordinuar me Ju, tetë nëndetëse dhe baza lundruese “Kotjelnikov” në orën 8⁰⁰ të 26 majit të vitit 1961, largohen nga Gjiri i Vlorës. Me respekt zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe kryetar i delegacionit sovjetik, N. Firjubin”.

Homologu shqiptar ia ktheu dhe ai me shkrim se Qeveria e RPSH nuk ka kundërshtim të largohen nga Gjiri i Vlorës 8 nëndetëse dhe baza lundruese “Kotjelnikov”, në të cilat shërbejnë ekuipazhe sovjetike, po ashtu nuk ka kundërshtim që ato të largohen më 26 maj 1961, ora 8⁰⁰²⁰. Mjetet e sipërpërmendura u larguan nga Vlora më 26 maj 1961. Me këmbënguljen e qeverisë shqiptare mjetet e tjera nuk u lejuan të largohen. Këto ishin katër nëndetëse, baza lundruese “Njemçinov”, 10 anije të vogla mbiujëse, 22 anije ndihmuese dhe një sasi armatimesh, teknike dhe materialesh të tjera. Për sa u përket ushtarakëve të fundit të mbetur, ato u larguan nga Vlora në ditët e para të qershorit²¹.

Ndërkohë, puna në komisionin e përbashkët u ndërpre. Pas pushimit për t’u këshilluar me qeverinë, delegacioni sovjetik nuk u kthye më në komision. Në takimin që iu kërkua me ngut homologut të tij shqiptar, Halim Budo, më 27 maj, ora 22, Firjubini njoftoi se delegacioni ishte thirrur në Moskë për të raportuar. Këto bisedime nuk u hapën më. Mjetet detare dhe pajisjet e tjera, të mbetura në Shqipëri, nuk u kthyen në BS, megjithëse sovjetikët nuk hoqën dorë nga pretendimi se ato ishin pronë e tyre. E njëjta gjë ndodhi edhe në rastin e dy anijeve të Flotës Ushtarake-detare shqiptare, të cilat prej muajsh ishin në Detin e Zi për remont, bashkë me ekuipazhet e tyre. Ekuipazhet u kthyen në Shqipëri, duke i lënë anijet në Portin e Sevastopolit, megjithëse qeveria shqiptare, po ashtu nuk hoqi dorë nga e drejta e pronësisë mbi këto mjete²².

Përmbledhtas, ky ishte historiku i marrëdhënieve mjaft të acaruara shqiptaro-sovjetike për Bazën e Vlorës. Mbetet të qëmtohet ende për pozicionimet e skajshme që u morën nga të dy palët, sidomos për arsyet. Për sovjetikët, të cilët aplikuan qëndrime përjashtuese ndaj shqiptarëve, edhe pse baza ishte në territorin e tyre. Kjo nën flamurin e Traktatit të

²⁰ *Po aty*. Në letrën e Halim Budos, ora 18.30 e asaj dite, thuhet gjithashtu: “Sikundër rezulton nga letra e lartpërmendur e qeverisë shqiptare, datë 8 maj 1961, si dhe nga bisedimet e zhvilluara midis dy delegacioneve tona, së bashku me këto mjete duhet të largohet edhe i gjithë personeli tjetër i forcave ushtarake detare sovjetike, që deri më sot ka shërbyer me cilësinë e instruktorëve në repartet e flotës ushtarake detare shqiptare dhe për të cilët nuk ndjehet më nevoja në flotën tonë ushtarake detare”.

²¹ *AMPJ*, viti 1961, dos. 42/5. Traktati i Varshavës, Deklaratë e qeverisë së BS, 3 qershor 1961.

²² *Po aty*, dos. 42/8. Traktati i Varshavës, Nota e Ambasadës së RPSH në Moskë për anijet në Sevastopol, 21 qershor 1961.

Varshavës. Te shqiptarët, ndoshta, duhet kërkuar më shumë rreth motiveve të kundërshtimit. Një gjë është e qartë, çështja e Bazës së Vlorës nuk mund të ishte e shkëputur nga gjithë zhvillimet e tjera, nga kompleksi i marrëdhënieve politike e shtetërore që po ndodhte në atë kohë. Ajo që bie në sy është se ndërsa kundërshtimi publik i qeverisë shqiptare është energjik, E. Hoxha ndjehet i lehtësuar për likuidimin e Bazës së Vlorës. Këtë ai e shprehu hapur në një mbledhje të Byrosë Politike, më 1 prill 1961, një ditë pasi u informua për vendimin e Komitetit Politik Konsultativ. Si një udhëheqës i formatit stalinist, ai e kishte shumë të qartë se në rrethanat e krijuara, Baza e Vlorës, si bazë e Paktit të Varshavës, mund të kthehej në një armë, siç shprehej ai “për rrezimin e udhëheqjes së PPSH” dhe “për pushtimin e Shqipërisë”²³. Duket se në vështrimin e tij, nga një mjet sigurie, Baza ishte kthyer në një rrezik më shumë.

Në mbledhjen e radhës të Komitetit Politik Konsultativ të Paktit të Varshavës, më 3 gusht 1961, një incident me delegacionin shqiptar të kryesuar nga Ramiz Alia, të cilit iu kërkuar të largohej nga mbledhja, me pretekstin e nivelit të përfaqësimit, shënoi përjashtimin *de facto* të Shqipërisë nga Pakti i Varshavës. Që nga ajo kohë e deri në vitin 1968, Shqipëria nuk ishte as brenda e as jashtë këtij pakti.

Ngjarjet e vitit 1961 tërhoqën vëmendjen e Perëndimit, veçanërisht të Shteteve të Bashkuara. Kemi të bëjmë kryesisht me orientime të diplomacisë amerikane, me raporte-info, por edhe me qëndrime zyrtare të shtetit amerikan. Gjithë kjo lëndë është ende e patrajtuar, kësisoj e panjohur për opinionin shqiptar. Në vështrim të kësaj teme, po përmend katër dokumente.

1. Një letër që Sekretari i Departamentit të Shtetit Din Rusk (Dean Rusk) i drejton ambasadorit amerikan në Greqi dhe për dijeni disa ambasadorëve në Evropë, më 17 nëntor 1961, në të cilën nënvizohet interesi aktiv i Shteteve të Bashkuara për Shqipërinë, si dhe rekomandohet kujdes për të mos u marrë asnjë hap nga vendet e Perëndimit, që mund të çonte në bashkimin përsëri të Pekinit me Moskën dhe që Shqipëria të tërhiqej nga sfida²⁴.

²³ AQPPSH, Fondi 14, viti 1961, dos. 37.

²⁴ *National Archives Record Administration* (më tej: NARA), Records of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Box 1926, November 17, 1961.

2. Dy letra përgjigjeje, njëra më 19²⁵ dhe tjetra më 21 nëntor 1961, që ambasadori amerikan në Beograd G. Kennan²⁶, autori i të famshmit “Telegrami i gjatë” dhe arkitekti i aksionit “Rollback” i shkruan D. Raskut, ndër të tjera, se Jugosllavia është ekstremisht e ndjeshme për çdo veprim me dhunë ndaj Shqipërisë, veçanërisht nga vendet e NATO-s, por dhe nga BS.

3. Gazeta “Los Angeles Times”, më 1 shkurt 1962, shkruan për raportin që ambasadori Kennan ka paraqitur në Komisionin për Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Senatin e Shteteve të Bashkuara. Që në krye veçohet se Kennan i rekomandon SHBA të adoptojnë një politikë

²⁵ *Po aty*, Roll no.1, Records of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Telegram no.778, 767.00/11-1961, Belgrade, November 19, 1961

²⁶ *Po aty*, Roll no.1, Records of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Telegram no.794, 767.00/11-2161, Belgrade, November 21, 1961.

George Kennan, historian, politolog, njëri nga diplomatët më të përmendur të SHBA gjatë Luftës së Ftohtë. Është autori i atij që njihet “Telegrami i Gjatë”, një telegram me gjashtë mijë fjalë, që i dërgoi Departamentit të Shtetit, më 22 shkurt 1946, kur ishte *i ngarkuar me punë*, në Ambasadën Amerikane në Moskë. Ky telegram, në të vërtetë, është një raport analitik për sistemin komunist sovjetik që, siç u shpreh atëherë Clark Clifford, këshilltar i Presidentit Truman në Shtëpinë e Bardhë, “është ndoshta mesazhi më i rëndësishëm, më me influencë, i dërguar ndonjëherë në Washington nga një diplomat amerikan”. “Telegrami i Gjatë”, si dhe një artikull tjetër i tij “Burimet e Qëndrimit Sovjetik” argumentonin që regjimi sovjetik në natyrën e vet ishte ekspansionist dhe se ndikimi i tij duhej frenuar. Këto dy materiale shumë shpejt u bënë si tekste fundamentale të Luftës së Ftohtë, duke shprehur politikën e re anti-BS të administratës së Trumanit. G. Kennan është edhe projektuesi kryesor i Projektit “Rollback”, i cili synonte përmbyshjen e regjimit komunist në vendet e Evropës Lindore, nëpërmjet bashkëpunimit të emigracionit të jashtëm me elementët antikomunistë brenda në këto vende.

Në vitet 1961-63, G. Kennan ishte ambasador i SHBA në Beograd dhe ndoqi nga afër zhvillimet në Shqipëri. Në telegramin e dytë, të datës 21 nëntor, i cituar në tekst, G. Kennan thotë se “në qoftë se Shqipëria do të mbetet një shtet komunist, asaj do t’i duhet të orientohet drejt disa entiteteve të tjera brenda botës komuniste...Në këtë kuptim, interesat tona afatgjata do të plotësohen më mirë me anën e zhvillimit të regjimit shqiptar sipas modelit të Jugosllavisë”. Më tej thotë: “Situata shqiptare është gjithmonë subjekt i ndryshimeve të papritura dhe të paparashikuara. Ne nuk mund të themi se çfarë do të sjellë e nesërmja. Ne nuk duhet të marrim vendime afatgjata, të cilat do të përjashtonin mundësinë e një përgjigjeje fleksibel dhe të menjëhershme”.

“Hands off” (të duarve larg, ose mosndërhyrjes) nga grindja e hidhur e Shqipërisë komuniste me BS²⁷.

4. Një studim²⁸ që përmban rekomandimet zyrtare të Departamentit të Shtetit, të Këshillit të Sigurimit Kombëtar dhe të Komisionit të Planifikimit të Politikave, më 26 janar 1962, ku, midis të tjerave, kërkohet të vijojnë konsultat me qeveritë greke, italiane dhe jugosllave për situatën në Shqipërinë fqinje dhe se Shtetet e Bashkuara nënvizojnë qëndrimin e “duarve larg” nga Shqipëria. I njëjti material, përmes Misionit amerikan në Organizatën Rajonale Evropiane në Paris, i përcillet edhe strukturave drejtuese të NATO-s, “për shkak se, edhe ajo është e interesuar për këtë subjekt”²⁹.

Në këto dhe materiale të tjera të kësaj kohe nënvizohet interesi i Washingtonit për ta afruar Shqipërinë me Perëndimin, por edhe rreziku si një zonë eksplozive në Ballkan dhe më gjerë. Moska duhet ta ketë parashikuar këtë. Prandaj ajo nuk e bëri hapin e përjashtimit të Shqipërisë *de jure* nga Traktati i Varshavës, pikërisht që të mund të përdorte të drejtën e ndërhyrjes në rast të një agresioni. Edhe pse Hrushovi i ndenji larg kësaj pike delikate për rajonin, në vetëdijen e shqiptarëve Pakti i Varshavës nuk sillte kurrfarë sigurie. Përkundrazi, pushtimi i Çekosllovakisë, më 1968, ktheu ankthin. Prandaj opinioni, brenda dhe jashtë vendit, e mirëpriti denoncimin që qeveria shqiptare i bëri edhe juridikisht Traktatit të Varshavës dhe largimin prej tij.

Shqipëria drejt NATO-s

Sapo ra sistemi komunist, bashkë me të u mbyll edhe historia e Paktit të Varshavës. Veprimet formale u bënë në një mbledhje të Komitetit Politik Konsultativ në Pragë, më 1 korrik 1991. Por, paralelisht në kohë, edhe NATO-s do t'i duhej të shqyrtonte rolin e vet në rrethanat e reja. Aq më tepër kur kishte zëra se “me kolapsin e BS, NATO humbi jo

²⁷ *Los Angeles Times*, Robert S. Allen & Paul Scott: “Caution Urged on Albania Issue”, February 1, 1962, p. B5.

²⁸ NARA, Roll no.1, Records of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, January 26, 1962, “*Immediate U.S. Policy Decisions Regarding Albania*”. Material i Departamentit të Shtetit i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Sigurimit dhe Komisioni i Planifikimit të Politikave.

²⁹ *Po aty*, Roll no.1, Records of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, nr. TOPOL A-226, February 21, 1962.

vetëm armikun e saj, por edhe arsye për të ekzistuar”³⁰. Për më se tri dekada e gjysëm dy blloqe ushtarake u vunë përballë njëri-tjetrit, provuan dhe tensione, por në të gjitha rastet i shmangën mrekullisht konfrontimet. Studiuesve të Luftës së Ftohtë u mbetet ende të eksplorojnë për këtë gjysmëshekull ankthesh, por dhe ekuilibresh mjaft funksionues. Ashtu siç mbetet për t’u studiuar e shpjeguar si NATO me mjete politike ia arriti në 42 vjet të ndalë ekspansionin sovjetik, por edhe pse ajo e pati të pamundur që, me të njëjtat mjete, të ndalte atë çka e pasoi shembjen e perandorisë komuniste, pikërisht shpërthimin e një vargu “luftërash etnike”.

Megjithëse debati për mbajtjen ose shkrirjen e NATO-s u tejkalua shpejt, prapëseprapë dilemat më të mëdha të NATO-s pas Luftës së Ftohtë duket se kanë qenë ato të zgjerimit. Kur pas shtatë vjetësh u ftuan në Aleancë tri vendet e para të Lindjes, Polonia, Hungaria dhe Republika Çeke, atëherë u tha se Senati amerikan, më shumë se për tre anëtarë të rinj, kishte votuar për një proces³¹. Kështu mori rrugë projekti për integrimin progresiv në NATO të shteteve postkomuniste të Evropës Lindore. Me këtë rast iu dha përgjigje edhe një shqetësimi tjetër të shfaqur për rrezikun e dy grupe kufijsh në Evropë: kufij që mbrohen me garanci sigurimi dhe të tjerë, të cilëve këto garanci u refuzohen, çka do të ishte “tunduese për agresorë potencialë dhe demoralizuese për viktime potenciale”³². Në këtë mënyrë, NATO ndërmori ndryshime thelbësore në strategjinë e vet, duke e zhvilluar idenë e sigurisë kolektive, që do të thotë se ajo merr përsipër jo vetëm të mbrojë nga një kërcënim i mundshëm territorin e çdo vendi anëtar, por të mbrojë edhe interesat e përbashkëta të sigurisë jashtë këtyre territoreve. Në këtë mision përfshihet dhe roli i saj si “*peacemaking*” dhe “*peacekeeping*”, dmth misioni i ndërtimit dhe i ruajtjes së paqes në vendet e kërcënuara apo të sapodala nga konflikti i armatosur. Prova e parë e ndërhyrjes ishte Bosnja. Dhe, pas saj, rasti i Kosovës është ndoshta demonstrimi më serioz i rivendosjes së prestigjit dhe besueshmërisë. Të dyja jashtë zonës.

³⁰ *NATO at Fifty: Perspectives on the Future of the Atlantic Alliance*, Lawrence Korb, “NATO: An Organization Whose Time Has Passed”, Center for Political and Strategic Studies, Washington D.C., 1999, p. 46.

³¹ *Po aty*; Jeremy D. Rosner, *NATO’s Credibility: Past, Present, and Future*, p. 78.

³² Henry Kissinger, *Diplomacia*, botim shqip, Tiranë 1999, f. 825.

Më 4 prill, Shqipëria mori ftesën e anëtarësimit për në NATO. Mendoj se mbetet për t'u shqyrtuar dhe shpjeguar orientimi masiv i shqiptarëve drejt Aleancës që në çastet e para të rënies së komunizmit. Ashtu siç do t'ia vliente më tutje që një ditë të studiohet edhe kjo fazë përgatitore, që prej vitit 1992, kur Shqipëria iu bashkua Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut e deri më sot. Mendoj gjithashtu se vullneti i shfaqur i klasës politike shqiptare për integrim në strukturat euroatlantike, me gjithë vështirësitë e tranzicionit dhe thyerjet në çaste të caktuara, sidoqoftë ka shkuar paralel me përkujdesjen që institucionet e vendit dhe qeverisja në përgjithësi të tentojnë standardet e demokracisë. Në pikëpamje strategjike, ky vend historikisht delikat për ekuilibret në Ballkan e më gjerë; ky vend, për të cilin rekomandohej politika "*Hands off*", tani është pjesë e një strategjie të mirëfilltë sigurie për rajonin. Ndërsa nga ana e saj, Shqipëria sot është një vend që jo vetëm konsumon, por edhe prodhon siguri.